



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

E K S T R A K T

i procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, mbajtur më 07.03.2023, duke filluar nga ora 16:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fiknete Bejta-LDK, kryesuese, Taulant Maxharraj-AAK dhe Radie Hoxhaj, LVV.

Munguan: Liridon Selmani-PDK dhe Mimoza Xhaka- Bllacaku-eksperte e jashtme.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit **Fiknete Bejta**, kryesuese e komitetit dhe propozoi këtë

REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
2. Miratimi i Kalendarit të punës së Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
3. Të ndryshme.

Para se të fillohet me diskutimin e pikave të rendit të ditës, kryesuesja e komitetit i uroi mirëseardhje anëtarës së re të komitetit znj. Radie Hoxhaj.

Kryesuesja konstatoi se njëzëri u miratua rendi i ditës.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Kryesuesja konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së pestë të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Pika e dytë

Miratimi i Kalendarit të punës së Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Fiknete Bejta, kryesuese tha se siç e kemi praktikuar në çdo fillim të vitit kalendarik të punës së komitetit, ne e prezantojmë një plan të punës dhe sot kam prezantuar një draft të planit të punës me rekomandimin që ne këtë vit mund t'i mbajmë gjashtë mbledhje të këtij komiteti, si dhe kam menduar që ta kemi edhe një koordinim me seancat e Kuvendit Komunal.

Për në muajin prill në rend dite do të kemi një informatë nga Drejtoria e Shëndetësisë për punën dhe planet e kësaj drejtorie për vitin 2023, ndërsa për në muajin maj do ta kemi një informatë nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale për punën dhe planet e kësaj drejtorie për vitin 2023.

Për në muajin qershor mbetet të shihet ndonjë propozim apo ndonjë shqyrtim i ndonjë teme që do të jetë në pajtim me Kuvendin.

Me që muajin korrik dhe gusht nuk do të kemi mbledhje, për muajin shtator kam menduar që si pikë diskutimi me qenë Propozim buxheti i Drejtorisë së Shëndetësisë për vitin 2024.

Për muajin tetor, si pikë diskutimi do të jetë shqyrtimi i kërkesave të tjera nga institucionet lidhur me Komitetin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, pasi që edhe muaji tetor njihet si muaji rozë që është fushata sensibilizuese kundër kancerit të gjirit, e që Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në vitin e kaluar ka qenë faktor i rëndësishëm në këtë fushatë.

Gjithashtu në këtë muaj parashihet edhe Informatë rreth raportit të punës së drejtorive përkatëse.

Me ligjin për komitete parashihet që brenda vitit të mbahen gjashtë mbledhje.

Taulant Maxharraj, tha se pajtohem me Planin vjetor të këtij komiteti, shpresoj ta kemi më shumë prezentë drejtoren e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, të kemi sa më shumë pika dhe aktivitete këtë vit. Njëkohësisht e ruajmë të drejtën për të sugjeruar dhe propozuar edhe ne gjatë këtij viti më shumë, përndryshe e mbështesim planin e propozuar.

Të gjithë e dimë që buxheti i Drejtorisë së Mirëqenies Sociale është goxha i mangët, i varfér ose i trashëguar gati i njëjtë gjithmonë prej viteve paraprake, prandaj do të ishte mirë që nivilit qendror t'i bëhet një sugjerim përritjen e buxhetit së paku 20% për vitin 2024, që para se të vijë buxheti në shtator.

Radie Hoxhaj, tha se do të ishte mirë që përmes këtij komiteti të merrej ndonjë iniciativë që shërbimi i patronazhit të jetë më aktiv, shërbim i cili shkon në vendet ku nuk ka njësi primare shëndetësore. Po ashtu kemi doktoresha dhe infermiere të cilat janë shumë aktive edhe pse kanë dal në pension, ato munden me kontribuar si p.sh. të shkojnë në vizita në zonat rurale e që këto shërbime mos me qenë vullnetare por me qenë me pagesë. Ka zona malore që nuk kemi asnjë njësi primare, kështu që është e dhimbshme, ne kemi kuadro, kemi doktoresha,

infermieri që janë të shkëlqyeshme dhe janë shumë të afta për me dhënë shumë kontribut, andaj duhet të lëvizim pak në këtë aspekt.

Fikneta Bejta, kryesuese tha se ky është një shërbim kronik faktikisht ne në muajin e kaluar kemi bërë disa vizita me dr. Izetin, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë në disa lagje të qytetit, si dhe ky shërbim vazhdon të jetë aktiv edhe në disa zona të tjera rurale. Sa i përket shërbimit që mund të bëhet nga stafi mjekësor i pensionuar, tha se ajo nuk mund të bëhet me pagesë, pasi që ka impakt buxhetor, kështu që në këtë drejtim ne aty po ngecim.

Taulant Maxharraj, tha se këtë detyrë tanë e kanë mjekët e rregullt dhe është një formë kujdestarie ose vizitat që i bëjnë në terren shkojnë bashkë me ndihmën e shpejtë, pra është një grup prej tre personave mjeku specialist, motra dhe shoferi i auto ambulancës.

Kryesuesja konstatoi se njëzëri u miratua Kalendar i punës së komitetit, me ç'rast ceku se varësish nga rrëthanat, si plotësim të tij, ne mund të shtojmë edhe ndonjë pikë të rendit të ditës.

Pika e tretë

Të ndryshme

Radie Hoxhaj, tha se do të ishte mirë të dijë hierarkinë e punës të Drejtorisë së Mirëqenies Sociale edhe të Drejtorisë së Shëndetësi që, ne mos më kërkuar atë të pamundurën, të veprojmë dhe të ofrojmë ide në kuadër të atyre kornizave që kanë ato.

Fikneta Bejta, kryesuese tha se mundemi ta sigurojmë rregulloren e punës për drejtorinë përkatëse për kompetencat, detyrat që i kanë dhe në kuadër të tyre pastaj ta kemi një orientim, si dhe për mbledhjen e radhës do ta ftojmë edhe drejtoren e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, e cila do t'i paraqet planet që i kanë planifikuar për 2023.

Kjo drejtori ka goxha plane ambicioze dhe po besoj që e ka edhe përkrahjen e Kryetarit dhe propozimet e komitetit që janë në të mirën e qytetarëve të Prishtinës, do t'i shtyjmë përpara që ato të paraqiten në Kuvend për diskutim.

Radie Hoxhaj, tha se duke pasur parasysh numrin e konsiderueshëm të shtresave të qytetarëve që kanë nevojë për përkrahje sociale, është mirë të bëjmë pak lëvizje në këtë drejtim, sepse ata njerëz janë shtresa më e varfér e shoqërisë, psh. këta që marrin ndihma sociale janë shumë edhe të hendikepuar, janë me një gjendje sociale jo stabile.

Taulant Maxharraj, tha se këto tema rrëth çështjes sociale vërtetë i kemi pasur si temë diskutimi edhe kur e kemi pasur prezent në mbledhje drejtoren. Duhet të ketë avancim në këtë fushë se ka shumë probleme dhe ishte dashur me ndryshuar kjo gjendje, sepse nuk mund të ecë, nuk mund të funksionojë kjo punë kështu.

Mbledhja përfundoi në orën 16:45.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Faqe 3 nga 3

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
<http://www.prishtina-komuna.org>

Kryesuesja e komitetit
Fikneta Bejta

